

EMBED PBrush
KËSHILLI I QARKUT LEZHË

STRATEGJIA

“PËR SIGURINË PUBLIKE
DHE
PARANDALIMIN E KRIMIT”

NË
QARKUN
E
LEZHËS

Botim i Këshillit të Qarkut Lezhë

Nën kujdesin Z. Bardh Rica

Hartuan dokumentin :

Preng Gjomarkaj

Hamit Toçi

Bashkëpunuan :

Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë

si dhe:

Martin Dedaj

Ndrekë Mhillaj

Lorenc Shehu

Përgatitën për botim:

Linda Maçi :

Viktor Gjokolaj

Përktheu në gjuhën angleze:

Arbana Dibra

Punoi në kompjuter

Afërdita Hoxha

Përmbajtja

Lista e terminologjisë dhe emërtesave të përdorura

Vështrim i shkurtër fiziko-gjeografik i Qarkut Lezhë

Mosfunksionimi i Komitetit Rajonal të luftës kundër trafikëve të qenieve njerëzore

Mbi nevojën e hartimit të këtij dokumenti

Synimi dhe rëndësia

Vizioni dhe misioni

Roli parandalues i fesë dhe OJQ

Partnerët

Organizimi i shërbimeve të policisë në Qarkun Lezhë (organigrama)

Prioritetet

Gjendja e rendit dhe sigurisë publike në momentin e hartimit të këtij dokumenti

Siguria rrugore, gjendja aktuale dhe masat që do të merren

Gjakmarrja, hakmarrja dhe konfliktet në tërësi

Lufta kundër korrupsionit aktiv dhe pasiv dhe krimit ekonomiko-financiar

Sjelljet antishoqërore

Krimi në familje

Lufta kundër kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të narkotikëve

Ruajtja e kufirit shtetëror

Bashkërendimi i punës së partnerëve

Disa nga linjat e bashkëpunimit midis partnerëve

Grupet konsultative polici-komunitet

Sa më pranë publikut

Bordet e parandalimit të krimit

Partneriteti, bashkëpunimi dhe transparenca e policisë me publikun

Partneriteti me biznesin lokal

Partneriteti dhe bashkëpunimi me NJQV

Partneriteti midis institucioneve arsimore dhe policisë

Prioriteti dhe bashkëpunimi me mediat

Objektivat afatmesme të partnerëve

Strategjitë plotësuese (ose pjesë përbërëse) të këtij dokumenti

Plan –veprimi për zbatimin e strategjisë

Bibliografia

Lista e terminologjisë dhe emërtesave, që janë përdorur.

KQ- Këshilli i Qarkut
DPQ-Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë
DRA-Drejtoria Rajonale Arsimore
ZA-Zyra Arsimore
NJQV- Njësitë e Qeverisjes Vendore
NDI-Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
KP-Komisariati i Policisë
SPSH- Stacioni i policisë së shtetit
OJF-Organizata Jofitimprurëse
AGJC-Arkivi i Gjendjes Civile
ARSH-Arkivi Rajonal Shtetëror
DRT-Drejtoria Rajonale e Tatimeve
SHISH-Shërbimi Informativ Shtetëror
DRBU-Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit
DSHP-Drejtoria e Shëndetit Publik
PKM-Policia Kufitare dhe Migracionit
DKSHA-Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Automjeteve
DPKM-Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit
SPKM-Stacioni i policisë Kufitare dhe Migracionit
ISKSH-Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
KPL-Komisariati i Policisë Lezhë
KPK-Komisariati i Policisë Kurbin
KPM-Komisariati i Policisë Mirditë
PSK- Politika e Sigurisë Kombëtare
GKPK- Grupet Konsultative Polici Komunitet
DRP- Drejtoria Rajonale e Punësimit
PDSH- Porti Detar Shëngjin
DSH- Dogana Shëngjin
SHPGJ-Shoqatat e Pajtimimit te Gjaqeve
KF-Komunitetet Fetare
DHTQ- Dhoma e Tregtisë së Qarkut
DSHPY-Drejtoria e Shërbimit Pyjor

Vështrim i shkurtër fiziko-gjeografik mbi rajonin e Qarkut Lezhë.

Qarku i Lezhës ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë. Në veri kufizohet me qarkun Shkodër, në verilindje me qarkun Kukës, në lindje dhe juglindje me qarkun Dibër, në jug me qarkun Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik, me gjatësi vije bregdetare 38 km (nga Rëra e Hedhur në Kepin e Rodonit).

Territori i qarkut të Lezhës, ka një sipërfaqe prej 1588.4 km² dhe një popullsi prej 218 094 banorësh, ku 40% e popullsisë jeton në zonat urbane dhe 60% në atë rurale. Harta administrative ngërthen 21 njësi vendore (16 komuna dhe 5 bashki), 9 qytete dhe 170 fshatra të rretheve Lezhë, Kurbin, Mirditë.

Mbi nevojën e hartimit të këtij dokumenti

Hartimi i këtij dokumenti i ideuar dhe i udhëhequr nga Kryetari KQ Lezhë z. Bardh Rika, do të ndihmojë për të konsoliduar urat e bashkëpunimit me publikun e gjerë, në përpjekjet e përbashkëta për arritjen e rezultatit të dëshiruar në fushën e sigurisë.

Ky dokument, shpreh qartë vullnetin e institucioneve shtetërore e shoqërore në rajon, për një luftë efikase në rritjen e sigurisë së komunitetit. Kjo do të arrihet përmes një pune të koordinuar, me qëllimin për të minimizuar veprimtarinë kriminale, e siguruar një jetë sa më normale të komunitetit të këtij rajoni, aktivitetëve të ndryshme private e shtetërore, vizitorëve vendas dhe të huaj etj.

Ky lloj angazhimi, është një përvojë pothuajse krejtësisht e re, si për grupin hartues, ashtu edhe për aktorët që do të bëjnë të mundur realizimin e tij.

KQ Lezhë, merr përsipër të luajë një rol të rëndësishëm në harmonizimin e përpjekjeve të institucioneve apo organeve të tjera vendore për të operuar në përputhje me politikën dhe strategjinë e Qeverisë Shqiptare.

Nxitja për këtë nismë, ka qenë strategjia dhe filozofia policore, sipas së cilës **parandalimi i krimit është më pak i kushtueshëm se zbulimi i tij, se parandalimi gjithashtu është më i domosdoshëm se reagimi.** Tashmë për kontrollin e krimit, shteti shpenzon përqindje gjithnjë në rritje të buxhetit (rreth 1 % GDP-se). Kjo bën që strategjinë e mirëplanifikuar të parandalimit të krimit të rrisin sigurinë e komunitetit, të krijojnë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit e të rrisin në një stad më të lartë cilësinë e jetës duke ulur koston financiare e sociale.

Vlera e këtij dokumenti, qëndron tek zbatimi dhe jo thjeshtë tek hartimi i tij. Gjithsesi shpresojmë dhe besojmë se partnerët do të bëjnë më të mirën e mundëshme.

Synimi dhe rëndësia.

Hartimi i kësaj strategjie, është jo vetëm detyrim që rrjedh nga prioriteti që ka përcaktuar Shteti Shqiptar për të luftuar krimin dhe gjithë format e shfaqjes së tij, por edhe nevojë për të harmonizuar e koordinuar më mirë angazhimin e institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në juridiksionin e Qarkut Lezhë.

Kjo strategji, merr përsipër të përcaktojë prioritetet strategjike të luftës për parandalimin e krimit në rajon, të përcaktojë objektivat e institucioneve që marrin detyrime si dhe të harmonizojë veprimet ndërinstytucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara. Ajo synon gjithashtu:

Të identifikojë gjerësisht fenomenin e shfaqjes së krimit në të gjitha format e tij në qarkun Lezhë, duke bërë një analizë thelbësore të shkaqeve e faktorëve të zhvillimit.

Të pasqyrojë veprimtarinë institucionale të të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të organizuar.

Të diagnostifikojë gjendjen në të cilën ndodhet rajoni ynë, kryesisht nëpërmjet dokumenteve, medias apo informacioneve të ndryshme.

Të përcaktojë prioritetet e objektivat që do të arrihen në minimizimin e krimit duke përmendur format kryesore të shfaqjes së tij.

Të përcaktojë masat që duhet të merren nga institucionet e ndryshme për arritjen e objektivave.

Të detajojë planin e veprimit, duke përcaktuar hapat që do të hidhen nga çdo institucion, bazuar në afatet e përcaktuara edhe dokumente të tjera si strategji e plane veprimi të veçanta.

Të përcaktojë rrugët e monitorimit të zbatimit të strategjisë.

Të përcaktojë nevojat apo burimet e mundshme financiare për realizimin e aktiviteteve në funksion të zbatimit të kësaj strategjie.

Lufta kundër krimit, dhe sidomos lufta për parandalimin e tij, nuk do të shihet thjeshtë si përgjegjësi vetëm e policisë së shtetit. Partneriteti midis aktorësh të ndryshëm është element shumë i domosdoshëm i efikasitetit të kësaj lufte. Prandaj dhe strategjia merr përsipër të bëjë ndarjen e detyrave e masave që do të merren nga institucionet e ndryshme. Natyrisht pesha më e madhe e përgjegjësive për treguesit e luftës do t'i mbetet Policisë së Shtetit, e cila duhet të realizojë edhe përqendrimin e informacionit dhe shpërndarjen e saj sipas objektivit të punës së secilit aktor.

Identifikimi i problemeve kryesore, që lidhen me sigurinë publike në Qarkun e Lezhës dhe përcaktimi i drejtimeve të punës së institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit, do të jetë njëri nga synimet e kësaj strategjie.

Siguria nuk mund të lulëzojë pa evakuuar fillimisht kërcënimin e dhunës nga hapësira publike. Nëpërmjet një bashkëpunimi e bashkërendimi efikas të punës së partnerëve, do të rritet në radhë të parë besimi publik ndaj autoritetit të shtetit në tërësi dhe konkretisht ndaj policisë në veçanti.

Kjo, për faktin se siç ka thënë shkrytari dhe filozofi nobelist Albert Kamy, (ndoshta duke mbidimensionuar rolin policor) : **“Polici është në qendër dhe në kryqëzim të të gjitha problemeve ekzistenciale të njeriut të sotëm”**. Nëse policia është forcë, ajo është një forcë e njerëzishme, thelbi i së cilës qëndron në misionin humanist për të mbrojtur të ligjshmen nga e paligjshmja, viktimën potenciale nga agresori eventual. Pa vënien në efikasitet të kësaj force, nuk ka dhe nuk mund të ketë zhvillim të

mëtejshëm të shoqërisë njerëzore. Besimi, ndërtimi(fitimi) dhe ruajtja e tij, është një proces i gjatë psikologjik, intelektual dhe faktorial. Pikërisht dhe kryesisht këtë (krijimin e besimit tek institucionet e shtetit), merr përsipër kjo strategji.

Vizioni dhe misioni.

Vizioni...

Një mjedis të sigurve për të gjithë banorët e rajonit të Lezhës, me rezidencë të përhershme a të përkohshme, transit apo vizitor, për të kryer veprimtari normale në çdo sipërmarrje.

Partneritet i policisë me komunitetin në funksion të parandalimit të krimit dhe rritjes sigurisë publike. ..

Misioni

Marrja në vazhdimësi dhe me efikasitet e masave për të mundësuar sigurinë e komunitetit nëpërmjet bashkërendimit të punës së partnerëve, bazuar në standarde sa më të përparura dhe bashkëkohore, do të jetë motoja, që do të karakterizojë veprimtarinë në fjalë.

Ky mision, do të mundësohet si rezultat i një zhvillimi të integruar dhe shumë kompleks të forcave të policisë, të organit të Prokurorisë, të Gjykatës, të autoriteteve të Qeverisjes vendore, të OJQ etj.

Këto zhvillime do të kenë në thelbin e tyre:

Sigurinë publike.

Parandalimin dhe luftën e vazhdueshme kundër kriminalitetit.

Respektimin me rigorozitet të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Menaxhimin e integruar të kufirit.

Rritjen e vazhdueshme të sigurisë rrugore.

Përmirësimin e infrastrukturës.

Policimin në komunitet, që do të aplikohet në vazhdimësi.

Logjistikën bashkëkohore

Roli parandalues i fesë dhe OJQ-ve

Detyrat dhe respektimi i të drejtave për jetë dhe liri fetare në vendin tonë, janë vlera që krijuesi sjell me vete, për çdo qenie njerëzore. Të vetëdijshme për këtë janë kultet fetare, kisha, xhamia, teqeja që bëhen mbrojtëse të drejtave themelore të çdo personi. Shenjtëria e tij Benediktit XVI, për sa i përket të drejtës për jetë shprehet:

“Është e detyrueshme të raportojmë dhunën (padsim) që i bëhet shoqërisë tonë. Pranë viktimave të konflikteve të armatosura, të terrorizmit dhe formave të ndryshme të dhunës, janë edhe vdekjet e heshtura të shkaktuara prej urisë, prej abortit, prej eksperimentimit mbi embrionet dhe prej eutanazisë”. Feja kërkon respektimin e të drejtave të gjithë secilit. Sipas fesë, faktorë kryesorë të krimit mund të jenë: personi, shokët e tij dhe familja. Njeriu ndikohet prej atij me të cilin shoqërohet, përfiton nga mendimet karakteri dhe veprimet e tij.

Ata që mendojnë se do të kenë sukses, predikon feja, duke shkaktuar shtypje, duke përhapur ligësi e përbuzje dhe duke vrarë njerëz, bëjnë një gabim shumë të rëndë. Zoti i ka dënuar të gjitha aktet e ligësisë, përfshirë terrorizmin e dhunën.

Komuniteti i rajonit tonë, është dalluar prej shumë kohësh për harmoninë, mirëkuptimin, respektin e për tolerancën e ndërsjelltë midis besimtarëve katolikë e atyre myslimanë. Për t’u vlerësuar e për t’u admiruar, është qetësia e rregulli që mbizotëron tek numri shumë i madh i pelegrinëve, jo vetëm katolikë, por edhe të besimeve të tjera që vizitojnë gjatë gjithë vitit Kishën e Shna Ndout.

Asnjë incident, p.sh. nuk ka ndodhur me 13 qershor të këtij viti edhe pse atë ditë afro gjysmë milioni vizitorë, ngjiten monopatet për tek vendi i Shenjtë.

Në këto e të tjera akte të virtytshme të komunitetit të qarkut tonë e më gjerë, partnerët, aktorët e realizimit të këtij dokumenti, duhet të nxjerrin mësimet e duhura e të verifikojnë veprimet për të parandaluar konfliktet, mosmarrëveshjet e krimin që ngrihet mbi dy të parat.

Partnerët

DPQ, IDN, OJF, KP Lezhë, Kurbin e Mirditë, Institucioni i Prefektit, prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë e Kurbin, DKSHA Laç, NjQV e qarkut, (Komuna/Bashki), DRA, DRP, DRT, SPM Shëngjin SHISH Lezhe, Mediat, SHPGJ, KF.

Që partneriteti të rezultojë i suksesshëm do të kërkohet:

Zgjerimi i linjave të komunikimit.

Ndarja e përgjegjësive ndërmjet aktorëve.

Kryerja e aktiviteteve të përbashkëta në bazë të planifikimit.

Është i pranueshëm nga të gjithë fakti, se policia nuk mund të jetë përgjegjëse e vetme për sigurinë e komunitetit pa përfshirjen e partnerëve, grupeve të interesit si dhe individëve në këtë proces.

- Elementi kryesor i partneritetit, do të jetë krijimi i strukturave të përbashkëta, ndarja e përgjegjësive, prioritetet e të cilave do të orientojnë punën parandaluese dhe goditëse ndaj krimit.

- Partnerët që do të mundësojnë realizimin e kësaj strategjie, do të respektojnë të drejtat dhe liritë e individit, pavarësisht përkatësisë shoqërore, do të njohin në detaje e të

respektojnë kulturën e traditat e komunitetit.

- Gjithashtu, do të rriten aftësitë komunikuese të partnerëve me publikun, duke krijuar standarde për këtë qëllim dhe duke ju dhënë akses qytetarëve në monitorimin e kësaj veprimtarie.

Këta elementë, do të shërbejnë si një instrument për krijimin dhe rritjen e besimit të ndërsjellët.

Organizimi i shërbimeve të policisë në Qarkun e Lezhës (Organigrama)

Shërbimet e Policisë së Shtetit në territorin e Qarkut të Lezhës, janë të organizuara sipas organigramës së shërbimeve të policisë në rang kombëtar.

DPQ Lezhë, është pjesë përbërëse e këtyre shërbimeve, që ushtron aktivitetin e saj në këtë territor, në funksion të ruajtjes dhe sigurisë publike dhe parandalimit të krimit, dhe është e organizuar në sektorë dhe seksione në drejtori, KP Lezhë, Kurbin, Mirditë, Stacionet e Policisë Shëngjin(Lezhë), Milot, Mamurras(Kurbin), dhe Reps (Mirditë).

Ndërsa për ruajtjen e vijës bregdetare dhe kalimeve të paligjshme të kufirit, në vijën bregdetare prej 38 km (27 milje), është organizuar shërbimi policor nëpërmjet Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit me rezidencë në Shëngjin, e cila ka vartësi në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Durrës. Në qytetin bregdetar ndodhet gjithashtu Porti Detar edhe Dogana. Këto struktura si dhe te gjithë partnerët në realizimin e kësaj strategjie, bashkëpunojnë në funksion të ruajtjes dhe sigurisë publike, zbulimit dhe parandalimit të veprave të ndryshme kriminale, kapjen dhe vënien përpara drejtësisë të autorëve të tyre.

Organigrama e Policisë së Qarkut Lezhë

Prioritetet

Ndërtimi i partneritetit

Koordinimi i plan – veprimeve në nivel vendor për parandalimin e krimit.

Thellimi i luftës kundër krimit të organizuar

Përmirësimi i punës për ndërtimin e besimit

Reduktim i mëtejshëm i krimit dhe i sjelljes antishoqërore

Bashkërendimi i punës së policisë me pushtetin vendor e aktorët e tjerë për rritjen e sigurisë rrugore

Përmirësimi i procesit të menaxhimit të burimeve mbështetëse

Menaxhimi i integruar i kufirit

Orientimi i donacioneve dhe i projekteve të zhvillimit

Puna e organeve të zbatimit të ligjeve dhe gjendja e rendit në momentin e hartimit të këtij dokument

Prioritetet kanë qenë :

Sigurimi i rendit dhe qetësisë publike në bashkëveprim me institucionet e tjera shtetërore, të cilat kanë detyrime ligjore për këtë problem, si dhe rritja e parametrave të sigurisë në akset rrugore.

Intensifikimi i masave policore për identifikimin, gjetjen dhe kapjen e personave në kërkim.

Parandalimi dhe zbulimi i veprave të ndryshme penale, kryesisht për ato të krimit të vrasjes dhe hartimi i detyrave për ndjekje dhe dokumentimi ligjor i autorësisë së tyre dhe i aktivitetit kriminal, sidomos të veprave penale të krimit të organizuar.

Krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit.

Ndërsa treguesit janë:

Rritja e cilësisë së shërbimit të të gjitha strukturave të policisë.

Reduktimi i nivelit të krimit komunitar, në krahasim me periudhat paraardhëse.

Ulja e numrit të aksidenteve automobilistike.

Parandalimi dhe ulja e rasteve të konsumit të narkotikëve në mjedise të caktuara.

Rritja e fuqisë zbuluese në krahasim me vitin e kaluar, sidomos në veprat penale kundër pasurisë.

Menaxhimi i burimeve mbështetëse, logjistike dhe financiare.

Ofrimi i shërbimeve sa më të shpejta e me etike ndaj shtetasve.

Përcaktimi i partnereve si dhe i problemeve që paraqiten në komunitet e mjedise të ndryshme.

PARAQITJE GRAFIKE **Veprat penale (2006-2010)**

	2006	2007	2008	2009	2010
Evidentuar gjithsej	298	277	564	619	894
Zbuluar	252	235	494	441	625
Forca zbuluese	84.2%	84.8%	87.6%	80%	70%
Autorë të implikuar	282	303	614	554	833
Ndaluar/Arrestuar	133	137	201	197	295
Ndjekur në gjendje të lirë	126	142	372	318	458
Shpallur në kërkim	23	22	35	38	80

Siç tregohet edhe në grafik, për vitin 2008, janë evidentuar dy herë më shumë krime të ndodhura se në vitin 2007, çka do të thotë se është reduktuar shumë ndjeshëm i ashtuquajtimi “ krim i fshehtë” ose e thënë ndryshe krimi i pa raportuar. Për periudhën në fjalë, janë evidentuar 1,5 herë , 1,8 herë dhe 2 herë respektivisht më shumë krime të ndodhura se në vitet 2005, 2006, 2007, duke rritur njëherazi edhe fuqinë zbuluese me 3 %.

Për vitin 2009 numri i evidentimeve ka qenë më i vogël. Por edhe forca zbuluese ka qenë më e ulët, ndërsa ka pasur më pak autorë të implikuar. Në 2010 kemi ulje të forcës zbuluese.

Sipas të dhënave të mësipërme, dinamika e evidentimit dhe zbulimit të krimeve nga ana e policisë, ka ardhur gjithnjë në rritje. Kjo, për arsye se puna e saj është organizuar mbi bazën e një ligji të standardeve evropiane dhe e shkëputur tërësisht nga

ndikimi politik në vendimmarrje dhe veprimtarinë operacionale. Sot, ashtu si tërë Shqipëria, edhe rajoni ynë dhe komuniteti, falë këtij organizimi, përkushtimi, profesionalizmi, kurajoje të efektivave të saj, janë shumë herë më të sigurte, dhe shumë herë më të qetë.

Aktualisht, vërejmë një tendencë në ulje të veprave penale si vrasje, vjedhje me armë të banesave, trafiqe njerëzore, etj. Këto rezultate, vijnë jo vetëm si pasojë e rritjes së forcës goditëse të policisë, por edhe të bashkëpunimit të kësaj të fundit me institucionet e tjera bashkëpunuese.

Nga krahasimi i punës së PQ Lezhë, me atë të PQ –ve , me të cilat kufizohet (Shkodër e Durrës), si dhe me mesataren si Republikë, në lidhje me forcën zbuluese të krimeve të ndodhura, vërejmë se:

PQ Lezhë, nëse i referohemi vitit 2008, ka patur një forcë zbuluese 0,3% më të lartë se PQ Shkodër, 2,3% më të lartë se PQ Durrës dhe 6,6% më të lartë se mesatarja në shkallë vendi.

	Në shkallë vendi	Durrës	Shkodër	Lezhë
Vepra penale të ndodhura	13 426	1 343	759	564
“ “ “ të zbuluara	10 858	1 146	663	494
Zbulueshmëria	81 %	85,3 %	87,3 %	87,6 %

Garancia dhe siguria, që Shqipëria ofron për investitorët e huaj, sa vjen e po rritet. Raporti i Bankës Botërore rendit Shqipërinë si vendin e dytë më të favorshëm në botë për të bërë biznes. Edhe rajoni ynë, është njëri ndër rajonet e Shqipërisë, që në sajë të bashkërendimit të punës të të gjithë aktorëve, biznesi zhvillohet në kushte të përshtatshme.

Biznesmenët në tërësi, shprehën falënderimet e tyre dhe konsideratën e lartë për angazhimin e përkushtimin e strukturave të shtetit për krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e aktivitetit privat.

E ndarë sipas strukturës, dinamika e veprave penale për vitin 2010 rezultojnë të jetë :

Krime kundër personit

Janë evidentuar 153 vepra penale, zbuluar 141, të kryera nga 170 autorë, prej të cilëve ndaluar/arrestuar 49 të dyshuar, hetohen në gjendje të lirë 47 autorë dhe janë shpallur në kërkim 34 autorë. Zbulueshmëria e këtyre krimeve është 92%.

Krime kundër pronës

Janë evidentuar 343krime kundër pronës, zbuluar 130 raste që janë kryer nga 192 autorë

të dyshuar, prej të cilëve 116 ndaluar/arrestuar, 24 të shpallur në kërkim, ndërsa 52 të tjerë hetohen në gjendje të lirë. Fuqia zbuluese është 38%

Armëmbajtje pa leje

Janë evidentuar 85 raste të armëmbajtjes pa leje, nga këto janë zbuluar 80 raste, me 91 autorë gjithsej, 63 prej të cilëve janë ndaluar, 17 persona të dyshuar ndiqen në gjendje të lirë, në kërkim 11.

Krime ekonomiko-financiare

Krime të karakterit ekonomiko- financiar, janë evidentuar gjithsej 77 raste, nga të cilat zbuluar 75, me 134 persona të implikuar, nga të cilët 18 janë të arrestuar/ndaluar, ndërsa 116 persona ndiqen në gjendje të lirë. Zbulueshmëria në drejtim të këtyre krimeve, është mjaft e lartë, në masën 99%.

Krime të rënda

Krime të rënda, janë evidentuar gjithsej 127 vepra penale, zbuluar 78 krime të kryera nga 107 autorë, nga të cilët 67 persona janë arrestuar/ndaluar, 14 të tjerë janë shpallur në kërkim dhe 24 të dyshuar hetohen në gjendje të lirë me një zbulueshmëri 61%.

Lufta kundër trafiqeve të paligjshme e narkotikëve

Janë evidentuar gjithsej 28 ngjarje dhe të zbuluar 23, me 26 të dyshuar nga të cilët 11 janë arrestuar e ndaluar, ndërsa 17 të tjerë ndiqen në gjendje të lirë. - Ndarë sipas figurës së krimit këto vepra penale janë:

- Trafik femrash për prostitucion 2 raste.
- Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit 1 rast.
- Trafik mjetesh motorike dhe shfrytëzim prostitucioni.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007, seksioni kundër trafiqeve të paligjshme, ka evidentuar 4 vepra penale më shumë, kjo si rezultat i një pune më të mirë të policisë në drejtim të dokumentimit dhe goditjes së veprimtarisë kriminale në fushën e krimit të organizuar.

Lufta kundër kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të bimëve narkotike.

Në radhë të parë, do të synohet përmirësimi i ndërveprimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore, të angazhuara në luftën kundër drogave.

Po ashtu, në bashkëpunim me pushtetin vendor, policia do të kontrollojë dhe evidentojë pasojat negative mbi shëndetin publik dhe mbi shoqërinë që vijnë nga përdorimi i drogës në rajonin e Lezhës.

Lufta kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës, mbetet një ndër prioritetet kryesore të kësaj strategjie. Qarku Lezhë, në sajë të punës sensibilizuese të policisë, prokurorisë e të qeverisjes vendore, nuk përfshihet në hartën (listën) e zonave të kultivimit të drogës (caanabis sativa)etj. Megjithatë, për vetë faktin e pozitës së përshtatshme gjeografike dhe të kushteve klimatike të favorshme të territorit të Qarkut të Lezhës (për zhvillimin dhe transportimin e bimëve), aktorët që marrin përsipër zbatimin e

kësaj strategjie do të punojnë në vijimësi për parandalimin e këtij fenomeni.

Aktorët pjesëmarrës, do të ndërmarrin fushatë të veçantë, për parandalimin e mbjelljes së bimëve narkotike, duke shfrytëzuar e përmirësuar përvojën e deritanishme. Gjithashtu, DPQ do të bashkërendojë punën me DRA, me OJQ etj. për të evidentuar dhe për të zbuluar përdoruesit e drogave me qëllim që të penalizohen ata.

Lufta kundër trafiqeve të tjera të paligjshme

Drejtimet kryesore ku do të përqendrohet lufta kundër trafiqeve të tjera të paligjshme do të jenë:

Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore

Lufta kundër trafikut të mjeteve motorike të vjedhura

Lufta kundër trafikut të armëve dhe municioneve

DPQ Lezhë, të bashkërendojë punën me NJQV, kryetarët e fshatrave e nd/administratorët e qyteteve për të zbuluar mjetet motorike të trafikuar (të vjedhura), trafikimit të armëve dhe municioneve.

Gjithashtu të mbajë nën vëzhgim tentativat për trafikim të qenieve njerëzore, me kryetarët e fshatrave dhe ndihmës administratorët e lagjeve të qyteteve.

Lufta kundër krimit ekonomik e financiar.

Sot në Shqipëri, por edhe në Qarkun e Lezhës, pothuajse është fituar beteja me krimin e organizuar e korrupsionin. Në sajë të angazhimit serioz të strukturave të policisë së shtetit janë në goditje të pandërprerë trafiqet dhe trafikantët e çdo forme.

Gjatë këtyre viteve është konstatuar një ndërgjegjësime në rritje të strukturave të policisë, lidhur me evidentimin dhe raportimin e veprimtarisë kriminale.

Veprat penale të evidentuara e të zbuluara nga seksioni i luftës kundër krimit ekonomik e financiar në tre vitet e fundit rezultojnë të jenë:

Nr.		Vitit 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
1.	Krime të evidentuara	59	184	112	77
2.	Krime të zbuluara	49	182	105	75
3.	Numri i autorëve	64	223	146	134

Është domethënë fakti se, në vitin 2010, është rritur përqindja e zbulueshmërisë së krimeve sikur shihet edhe në grafik. Krimet kanë qenë të natyrës:

- për mashtrim në sigurime shoqërore,
- për veprën penale të kontrabandës,
- për mashtrim me pasaporta të falsifikuara,
- për falsifikim të akteve të gjendjes civile,
- për përdorim të kartëmonedhave të falsifikuara,
- për shpërdorim të detyrës dhe moskallëzim të krimit etj.

Megjithatë, në të ardhmen, kërkohet një përmirësim i mëtejshëm i metodave të raportimit të krimit nëpërmjet formimit të statistikave të sakta. Kriminaliteti i evidentuar deri më tani, nuk pasqyron realisht shkallën aktuale të krimit. Kjo vjen se nuk denoncohen të gjitha krimet e ndodhura, sidomos ato seksuale, por edhe të dhunës në familje e të keqtrajtimit të të miturve etj.

Për këtë arsye, strukturat e PQ Lezhë, në bashkëpunim me partnerët e kësaj strategjie, sidomos me NJQV, me kryetarët e fshatrave dhe ndihmës administratorët e lagjeve në qytete, me komunitetin në tërësi, do ta intensifikojnë punën për denoncimin e krimit të pa raportuar, i të ashtuquajturit “krim i fshehtë”.

Paraqitja grafike për kriminalitetin në rrethin e Kurbinit: Për vitet 2006-2010

	2006	2007	2008	2009	2010
Vepra penale të ndodhura	95	73	96	156	313
Vep Pen. të zbuluara	76	61	82	117	208
Përqindja e zbulueshmërisë	80%	84%	85.4%	75%	65%

Paraqitja grafike e kriminalitetit në rrethet Lezhë e Mirditë Për vitin 2009-2010

EMBED Excel.Chart.8 \s

EMBED Excel.Chart.8 \s

	Lezha		Mirdita	
	2009	2010	2009	2010
Vepra penale të ndodhura	139	248	35	98
Të zbuluara	116	167	31	70
% e zbulueshmërisë	84%	68%	88%	71%

Siguria rrugore, gjendja e tanishme dhe masat që do të merren

Në Qarkun Lezhë, ashtu si edhe në të gjithë Republikën e Shqipërisë, shërbimi i policisë rrugore është një aktivitet që bazohet në parandalimin, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor, për kryerjen e shërbimeve të drejtpërdrejta për menaxhimin e trafikut, kontrollin e dokumentacionit të mjeteve dhe kontrollin e përdorimit të rrugës.

Numri gjithnjë në rritje i mjeteve të motorizuara dhe gjendja e infrastrukturës rrugore janë reflektuar në një numër të lartë të aksidenteve rrugore. Por forcimi i kontrollit nga ana e policisë rrugore dhe ndëshkimi i drejtuesve të automjeteve që shkelin rregullat e qarkullimit (për më tej shih grafikun përkatës), kanë bërë që të ulet numri i aksidenteve dhe i viktimave sidomos në autostradën Lezhë-Fushë Krujë, “që tashmë ky segment rrugor ka filluar të artikulohet si “autostrada e vdekjes” dhe rrugët e tjera në territorin e këtij qarku.

Për vitin 2010, janë regjistruar gjithsej 129 aksidente, me 52 të vdekur, 39 plagosje të rënda dhe 87 plagosje të lehta, ndërkohë që gjatë vitit të 2009, u regjistruan gjithsej 52 aksidente, me 32 të vdekur e 35 të plagosur. Duhet vënë në dukje se situata kaotike në trafik ka ndodhur për:

Mungesë në edukim /njohuri të përdoruesve të rrugës.

Mentaliteti e popullatës.

Sjellje të papranueshme të përdoruesve të rrugëve.

Mungesë të shenjave/tabelave në rrugë.

Mosfunktionim në disa raste të semaforëve.

Vijëzime të pamjaftueshme në rrugë.

Trafik me një mbingarkesë/densitet të lartë të mjeteve.

Mirëmbajtje jo të rregullt të rrugëve.

Mungesë në lidhje me trajnimin dhe edukimin e policëve.

Mospranim të zbatimit dhe bindjes ndaj rregullave kryesore të qarkullimit.

Në autostradën Fushë Krujë-Lezhë, numërohen mbi 15 degëzime, me shumë hyrje, të automjeteve si zëtorë, kombajna, fadroma etj.

Për rrjedhojë, segmenti rrugor është shumë i ngarkuar përse i përket fluksit të automjeteve e rrjedhimisht është me premisë për më shumë aksidente. Pikërisht për këtë, për të zvogëluar e minimizuar numrin e aksidenteve, policia rrugore e qarkut ka shtuar kontrollet dhe ndëshkimet për drejtuesit e automjeteve që shkelin rregullat e qarkullimit.

Masat administrative në qarkullimin rrugor (gjobat) 2007-2010

2010	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti
Masa administrative (gjoba) 40059	26000	32000	25000	
Vlera në lek e gjobave të aplikuara 40752410	17888087	27803820	22000000	
Vlera në lekë e gjobave të arkëtuara	10630364	18469020	17200000	

45042221

Shënim: Në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2010-t, në organizimin e ri u krijuan “Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore” në të gjitha qarqet e vendit që nuk varen më nga Drejtoria e Policisë së Qarkut por nga Drejtoria Qendrore në Policinë e Shtetit. Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore të Qarkut Lezhë i kaloi në varësi edhe Policia Rrugore e Rrethit të Krujës.

Duke parë numrin e lartë të aksidenteve me pasojë për jetën e shtetasve (i cili paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm), numrin e madh të shkeljeve të rregullave të trafikut, nevoja për të patur drejtues mjetesh sa më të kualifikuar trajtimi me prioritet i sigurisë rrugore kthehet në domosdoshmëri.

Paraqitja grafike për aksidentet automobilistike në shkallë qarku

	2007	2008	2009	2010
Aksidente gjithsej	87	68	52	129
Aksidente me pasoje vdekjen	40	32	32	52

Plagosje të rënda	46	35	22	39
Plagosje të lehta	43	44	13	87

Ngjarjet e ndodhura në akset rrugore, kryesisht në autostradë, përbëjnë shqetësim jo të vogël për komunitetin. Për normalizimin e situatës nuk do të mjaftonin vetëm masat shtrënguese të policisë rrugore ndaj drejtuesve të mjeteve, por një sërë masash tekniko-organizative të partnerëve në bashkëpunim, për të përmirësuar infrastrukturën rrugore. Për këtë duhet të kryhet studimi për mundësinë e vendosjes së mbikalimeve e nënkalimeve, në nyjet më problematike, për kompletimin me një sinjalistikë bashkëkohore, siç janë semaforët, shenjat detyruese, treguese, orientuese, vijëzimi në rrugë etj.

Në afërsi të shkollave, ku nuk ka tabela, por dhe nuk respektohen ato, (si masë e përkohshme) nga drejtuesit e mjeteve, të vendosen pengesa llastiku me qëllim uljen e shpejtësisë. Partnerët e kësaj strategjie do të konsiderojnë dhe do të ndërmarrin veprime konkrete për trajnimin dhe edukimin e mëtejshëm të efektivave të policisë rrugore me qëllim që ato të aftësohen profesionalisht .

Gjithashtu, partneret do të koordinojnë punën në lidhje me trajnimin dhe edukimin e nevojshëm të përdoruesve të rrugëve automobilistike. Kjo punë, do të përcillet nga policia, nga mediat e shkruara dhe ato vizive e sidomos nga masa e mësuesve dhe nxënësve.

Vendosja e të ashtuquajturve "oficerë civilë" me fondet e pushtetit vendor nga drejtuesit e Bashkisë Lezhë, në disa kryqëzime kryesore të qytetit, kryesisht për të ndihmuar nxënësit e shkollave në prerjen e detyruar të rrugëve, ka qenë dhe është, një nisëm e realizuar me sukses dhe e mirëpritur nga komuniteti.

Gjakmarrja, hakmarrja dhe konfliktet në tërësi

Gjakmarrja dhe hakmarrja, vitet e fundit, kanë prekur në një farë mase jo vetëm burrat, por edhe gratë dhe fëmijët, gjë që flet për një deformim të normave dhe përcaktimeve të hershme kanunore. Studimet e rasteve të gjakmarrjes, tregojnë se pjesa më e madhe e tyre rrjedhin nga konflikte e hasmëri të viteve të fundit të periudhës së tranzicionit dhe jo të trashëguara nga thellësitë e viteve. Kjo vlen edhe për hakmarrjen, e cila në ndryshim nga gjakmarrja haset më dendur dhe ushqehet nga motive nga më të ndryshmet.

Edhe në Qarkun e Lezhës, si në gjithë Shqipërinë, në vitet 90, demokratizimi i vendit u shoqërua nga liberalizimi i çdo sferë të jetës. Dihet se shteti diktatorial, siç hoqi të drejtën e fjalës, të drejtën e shprehjes së mendimit ndryshe, ushtrimin e rriteve fetare, shtetëzimin e institucioneve të kultit dhe kthimin e tyre kryesisht në magazina për prodhimet bujqësore, por edhe për shërbimet e tjera të çfarëdollojshme, shpronësoi me dhunë dhe pa asnjë shpërblim, të gjithë shqiptarët. Prandaj, procesi i privatizimit në shkallë të gjerë, do të pasohej me mjaft konflikte për motive pronësie midis shtetasve të ndryshëm, që një pjesë e tyre përfunduan me krime të rënda. Jo pak zyrtarë e persona të tjerë, të ashtuquajtur sekserë, u përfshinë në korrupsionin e shitblerjes së tokave.

Privatizimi, përveç efekteve të pritshme e të shumëdëshiruara, përsa i përket lirive

e të drejtave të njeriut, solli edhe dukuri që dëmtuan besimin e shoqërisë në autoritetin e shtetit dhe në perspektivën e saj. Kështu, korrupsioni, lëvizja kaotike demografike, mosrespektimi i rregullave e ligjeve solli krijimin e informalitetit në shoqëri (ekonomi, demografi etj) e mandej rritjen në përmasa të konsiderueshme të kriminalitetit.

Policia e shtetit, pushteti vendor, shoqatat e zgjidhjes e të pajtimit të konflikteve, si dhe tërë komuniteti në qarkun e Lezhës, kanë shfaqur ndjeshmërinë dhe vlerësimin maksimal ndaj këtyre fenomeneve. Krahas masave të tjera, do të krijohen, në zbatim të këtij dokumenti, struktura të posaçme për parandalimin dhe luftën kundër konflikteve e konfrontimeve që çoi në gjakderdhje.

Prandaj në zbatim të këtij dokumenti, veprimtaria e të gjithë aktorëve, institucioneve shtetërore dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, do të fokusohet: Në evidentimin e përpiktë të konflikteve dhe të motiveve të tyre.

Në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë së organeve të zbatimit të ligjit.

Në hartimin dhe zbatimin e një strategjie vendore të posaçme, për parandalimin dhe pajtimin e konflikteve e të mosmarrëveshjeve.

Është detyrë e partnerëve të këtij dokumenti, që nëpërmes veprimtarive të ndryshme të mund të sensibilizojnë opinionin publik, jo vetëm për pasojat tragjike të fenomenit të hakmarrjes e të gjakmarrjes, por njëherësh edhe për informacionet e pasakta që publikohen nga mediat e shkruara e vizive. Po kështu, mediatorët që merren me pajtimin e mosmarrëveshjeve e të gjaqeve, megjithë punën e mirë që kanë bërë e bëjnë, ndonjëherë raportojnë shifra fiktive dhe pompoze, lidhur me rastet e pajtimeve apo të familjeve të ngujuara.

Gjendja aktuale e konflikteve të evidentuara është si më poshtë:

Numri i përgjithshëm i konflikteve të evidentuara si qark	284.
Konfliktet për gjakmarrje/hakmarrje	141.
Konflikte pronësie të evidentuara	128.
Konflikte brenda familjes të evidentuara	15.
Persona të ngjuar gjithsej	24.
Fëmijë të ngjuar aktualisht nuk ka.	

Këto të dhëna të shprehura në përqindje rezultojnë:

Konfliktet për hakmarrje/gjakmarrje përbëjnë 49.64% të numrit të përgjithshëm të tyre.

Konfliktet e pronësisë përbëjnë 45.7% të konflikteve të përgjithshme.

Konfliktet e brendshme familjare të evidentuara përbëjnë 5.29% të numrit të përgjithshëm.

Që numri i vrasjeve për gjakmarrje po vjen në rënie nga viti në vit, e tregon edhe statistika e dhënë në shkallë republike:

Vrasje për gjakmarrje:

në vitin 2005 5 raste ,
në vitin 2006 4 raste,
në vitin 2007 asnjë rast,
në vitin 2008 asnjë rast
në vitin 2009 9 raste (janë zbuluar

8, vrasjet s'janë bërë për gjakmarrje).
në vitin 2010 nuk ka

Në rrethet Lezhë, Mirditë e Kurbin, krahas fenomenit të gjakmarrjes, ka funksionuar edhe institucioni i pajtimit midis personave apo familjeve në konflikt apo në hasmëri. Ky institucion, ka vepruar edhe për shuarjen e konflikteve të lindura për motive nga më të ndryshmet, duke parandaluar aktet ekstreme kriminale që janë vrasjet.

Pas një ndërprerje prej rreth 50 vjetëve të lëngimit në diktaturë, në vitin 1993, u Kuvendi i Parë kombëtar i pajtimit të gjaqeve në Laç të Kurbin, iniciuar dhe drejtuar nga kleriku i shquar, Frano Ilia. Më pas, në frymën e këtij kuvendi janë bërë disa pajtime, falje gjaqesh jo vetëm në Kurbin, por në të gjithë rajonin. Partnerët e këtij dokumenti, policia, NJQV, kryetarët e fshatrave, nd/administratorët në qytete, në kuadër të parandalimit të krimit, do të bashkërendojnë punën me mediatorët e pajtimeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun e Lezhës.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit ekonomiko- financiar

Në këndvështrimin aktual, korrupsioni jo vetëm është një nga format konkrete të shfaqjes së krimit ekonomik të organizuar, por përgjithësisht, ai është edhe pjesë organike që i paraprin realizimit të këtij krimi.

Ecuria e krimit ekonomik të organizuar dhe fuqizimi i tij, ka bërë që korrupsioni, të ketë kapitale të mëdha, të cilat hidhen në veprim në momentin e duhur për të mposhtur zyrtarët e administratës, për t'i hapur shtigje të reja krimit ekonomik të organizuar.

Shfaqjet e korrupsionit në tenderat e ndryshëm, në prokurim fondesh, blerje e investime, në procesin e privatizimit, në fushën e dhënies së kredive bankare etj, kërkojnë një kontroll dhe vlerësim të vazhdueshëm nga organet e specializuara. Më i mprehtë dhe me pasoja edhe më të rënda, bëhet korrupsioni në investimet e mëdha të fushës së ndërtimit të rrugëve, ujësjellësve, bujqësisë etj, pasi shpesh, grupet e ndryshme kriminale, paraqiten si investitorë potencialë.

Krimi ekonomiko-financiar, është krim “ i heshtur”, “ i fshehtë”, që në momentin e shpërthimit krijon tronditje.

Partnerët e realizimit të kësaj strategjie, DPQ, Prokuroria, DRT, NJQV-të etj. do të intensifikojnë punën si kundër korrupsionit në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat për të stimuluar jo vetëm konkurrencën, por për të shmangur edhe viktimizimin e qytetarëve.

Për reduktimin e këtij lloj krimi, do të ngrihen grupe pune të përbashkëta me pjesëmarrjen e partnerëve. Kjo luftë duhet të përfshijë të gjithë shoqërinë, në mënyrë të veçantë, organet e specializuara si auditimin në institucionin e Qarkut, e të Prefekturës, gjykatat e rretheve gjyqësore. Ky fenomen, do të ndiqet duke bashkëpunuar e shkëmbyer informacione reciproke, për krimin e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, për vjedhjet nga brenda, për shpërdorim të detyrës, për kontrabandën, mashtrimin, tjetërsimin e pasurisë, pastrimin e parave mitmarrjen etj.

Sjelljet antishoqërore

Sjellje antishoqërore konsiderohen të gjitha veprimet që cenojnë qetësinë publike dhe sjellin shqetësim të komunitetit. Të tilla konsiderohen sjelljet e pahijshme në ambiente publike, vandalizmat e grupeve të të rinjve, përdoruesve të alkoolëve të të gjitha moshave, përgjithësisht veprime që prishin rendin dhe qetësinë publike etj. Dhuna në familje, konfliktet, mosmarrëveshjet, hakmarrja, gjakmarrja, trafiket njerëzore, etj.

Meqenëse sjellje të tilla përbëjnë një shqetësim të madh për komunitetin, dëmtojnë besimin publik te ligji dhe shërbimet publike, Nj.Q.V, Policia e Shtetit dhe OJF-të, duhet të iniciojnë projekte e aktivitete të përbashkëta me komunitetin dhe me të gjithë partnerët për parandalimin e tyre. Gjithashtu është shumë e nevojshme (dhe këtë do ta bëjnë partnerët në vijimësi), krijimi sistematik i evidencave statistikore për sjelljet anti shoqërore.

Punonjësi i policisë në zonë, në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave, nd/ administratorët e lagjeve në qytete dhe me elementë të tjerë të grupeve konsultative, të përpilojnë informacione të sakta e të formulojnë më mirë se deri më tani statistika herëpasëhere, për problemet që ndodhin realisht në terren, për natyrën e tyre, për kapjen dhe tendencat që ato kanë, kërcënimet për rreziqet që mund të sjellin ato.

Krimi në familje

Ndryshimet e hovshme të shoqërisë shqiptare, janë reflektuar edhe në marrëdhëniet familjare dhe si pasojë gjatë këtyre viteve është vënë re një rritje e rasteve të raportuara përse i përket dhunës së ushtruar, krimit në familje. Tashmë dihet se, për vetë mentalitetin ekzistues të komunitetit, krimet seksuale dhe ato të dhunës familjare, e të keqtrajtimit të të miturve, nuk raportohen, përveç se një përqindje e vogël e tyre. Kjo dukuri, pra, ajo pjesë e krimit të padenoncuar, përbën atë që quhet “krimi i fshehtë”. Një numër i konsiderueshëm veprash penale kanë ndodhur për shkak të ashpërsimit të konflikteve familjare, për motive nga më të ndryshmet si për pronësi, xheloz, varfëri, degradime mendore etj. Prandaj, për trajtimin e këtij fenomeni shqetësues, rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi, pasi policia e vetme është e pafuqishme t’i japë zgjidhje.

Në qarkun tonë, për vitin 2010në zbatim të ligjit 9669 datë 18.12.2006 “ Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, janë evidentuar 84 vepra penale brenda ambienteve familjare , nga këto 62 kërkesë padi (urdhra mbrojtjeje) dhe 22 vepra të ndryshme.

Është detyrë e partnerëve të kësaj strategjie, e policisë, prokurorisë, NJQV-ve etj që të bashkërendojnë punën e të ndërmarrin veprimtari të ndryshme për sensibilizimin e komunitetit për të raportuar çdo krim që ndodh në familje. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë, do t’i kushtohet zhvillimit të veprimtarive sipas planeve për parandalimin e dhunës në familje. Aktorët realizues të këtij dokumenti, do të marrin menjëherë në mbrojtje denoncuesin (të dëmtuarin).

Ruajtja e kufirit shtetëror

Qarku i Lezhës ka një vijë kufitare 38 kilometra.

Menaxhimi dhe siguria në këtë pjesë të kufirit blu të qarkut të Lezhës, do të jenë prioritet i aktorëve realizues të kësaj strategjie.

Forcimi i kontrollit të kufirit për të parandaluar aktivitetet kriminale si dhe çdo aktivitet tjetër që, mund të vërë në rrezik sigurinë e vendit, është synim prioritar i këtij dokumenti.

Për këtë, do të forcohet bashkëpunimi midis stacionit të PKM, stacionit të policisë së shtetit Shëngjin, Prokurorisë NJQV, Drejtorive të shkollave, kryetarëve të fshatrave apo lagjeve etj

Bashkërendimi i punës së partnerëve

Siguria, nuk është më atribut vetëm i njeriut të zbatimit të ligjit apo e thënë më thjeshtë, e policit. Sfidat e jetës kërkojnë angazhimin e të gjitha qelizave të shoqërisë për të arritur standarde të larta në fushën e sigurisë.

Është fakt i pakundërshtueshëm, angazhimi i strukturave shtetërore për të bërë të vërtetë dhe të dobishëm këtë bashkëpunim, forcimi i të cilit, do të sillte më shumë transparencë dhe besim reciprok në përpjekjet e përbashkëta për rritjen e standardeve të sigurisë publike. Pa këtë bashkëpunim, nuk mund të ketë rezultate të larta në sigurimin e rendit dhe parandalimin e krimit. Në radhë të parë, policia e shtetit e prokuroria, duhet të kërkojnë bashkëpunimin me aktorët e tjerë e sidomos me pushtetin vendor, për të gjetur format e duhura të krijimit të urave të komunikimit të partnerëve e të ndarjes së përgjegjësisë. Nga ana tjetër, pushteti vendor, duhet të luajë një rol më aktiv edhe në realizimin e detyrimeve të tij, përta i përket sigurisë publike.

Duhet thënë se deri më tani, kontakti i organeve të zbatimit të ligjit me qytetarët, ka qenë jo gjithnjë i planifikuar, por ka mbizotëruar rastësia dhe spontaniteti. Nuk ka ekzistuar një formë e institucionalizuar, për të organizuar takime të drejtpërdrejta me qytetarët, me qëllim që të rritej edhe më shumë besimi i komunitetit ndaj saj dhe rrjedhimisht edhe i bashkëpunimit midis tyre.

Policia, prokuroria, gjykatat, pushteti vendor në tërësi, kur realizojnë bashkëpunimin midis tyre dhe publikut të gjerë, arrijnë të fitojnë edhe besimin e tyre.

Dihet se besimi nuk i jepet një të pabesuari apo atij që e shpërdoron atë. Prandaj është detyrë e të gjithë partnerëve të kësaj strategjie që gjatë zgjidhjes së preokupimeve të komunitetit të mos e zhgënjnë atë, por të tregohen të drejtë, të paanshëm, e profesionistë të vërtetë.

Filozofia e policimit në komunitet kërkon ndryshim mentaliteti edhe në realizimin e bashkëpunimit.

Policia e shtetit, që operon në rajonin tonë, duhet të ndërgjegjësohet edhe më shumë se është pikërisht ajo në radhë të parë, që duhet të kërkojë e të realizojë bashkëpunimin me aktorët e tjerë e sidomos me pushtetin vendor. Duhet të gjenden format e përshtatshme të krijimit të urave të komunikimit, të partneriteteve e të ndarjes së përgjegjësisë.

Nga ana tjetër, pushteti vendor, duhet të luajë një rol më aktiv edhe në realizimin e detyrimeve të tij përta i përket sigurisë publike. Nëse misioni i tij është i “ qeverisjes në

nivel sa më pranë qytetarëve” siguria publike do të jetë një nga detyrimet kryesore të tij.

Disa nga linjat e bashkëpunimit midis partnerëve

Bashkëpunimi i DRT me Prokurorinë, DPQ, NJQV etj, për identifikimin e rasteve të pastrimit të parave dhe të krimit ekonomik në qarkun e Lezhës.

Bashkëpunimi i DPQ me DRA, në përmbushje të akt-marrëveshjes “Për luftën kundër fenomenit të përdorimit dhe shpërndarjes së drogës në ambjentet shkollore”.

Bashkëpunimi i DPQ

, Prokurorisë Lezhë dhe Kurbin, SHISH, NJQV të Qarkut dhe DRBU në përmbushje të akt-marrëveshjes “Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike”.

Bashkëpunimi midis DPQ dhe DSHP, DISKSH në zbatim të akt-marrëveshjes “Për forcimin e masave të kontrollit kundër prekursorëve dhe drogave që përdoren në mjekësi”.

Grupet konsultative polici-komunitet

Me IDN, deri më tani, janë zhvilluar disa takime në DPQ me përfaqësues të pushtetit vendor, intelektualë të qytetit, pensionistë, nd/administratorë të lagjeve etj. dhe që të gjithë së bashku, përbëjnë atë që quhet “Grupi konsultativ” pranë DPQ.

Temat që janë trajtuar e do të trajtohen, në këto takime, kanë qenë e do të jenë të ndryshme dhe të larmishme për diskutim ndërmjet pjesëmarrësve si:

Përmirësimi i marrëdhënieve komunitet-polici.

Rrugët dhe alternativat e funksionimit të këtij bashkëpunimi.

Çfarë duhet të bëjë policia, pushteti vendor dhe aktorët e tjerë për të qenë sa më pranë komunitetit?

Në të ardhmen, drejtuesit e PQ dhe sidomos Drejtori, ashtu siç është vepruar deri më tani, madje në mënyrë edhe më të planifikuar, duhet të marrin takime në zyrën e kryetarit të KQ, për probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë dhe parandalimin e krimit në komunitet. Po kështu, duhet të veprojnë edhe shefat e komisariateve të nënprefekturave, duke marrë kontakte me kryetarët e bashkive/komunave. Në shtator të këtij viti, por edhe më parë, drejtuesit e policisë së qarkut, kanë raportuar në mbledhjen e KQ Lezhë për punën që ka bërë e bën policia e shtetit në rajon.

Në këto takime, është realizuar komunikimi direkt me të zgjedhurit, duke i pyetur ata për shqetësimet që kanë në objektin e punës së tyre. Kjo ka bërë të mundur që shumë konflikte, sidomos ato për probleme pronësie por, edhe konflikte me motive të tjera të zgjidhen pa zvarritje burokratike.

Kujdesi ndaj lëndëve plasëse.

Qëndrimi sa më pranë publikut dhe bashkëpunimi me të, është një garanci për të siguruar zbatimin e ligjit dhe garantimin e rendit për të gjithë. Luftës së gjithanshme që

duhet t'i bëhet krimit është edhe kontrolli e siguria e lëndëve plasëse, që përdoren nga subjektet private apo shtetërore.

Ngjarjet e ndodhura, si rezultat i përdorimit të lëndëve plasëse dhe shpërthyes, në pronën private apo shtetërore si banesa, dyqane, makina etj. na bëjnë të mendojmë për një drejtim dhe organizim më të kualifikuar në sferën parandaluese e kontrolluese në sigurimin e rendit e qetësisë publike.

Zbatimi, respektimi i rregullave të përdorimit, sigurimit, trajtimit, e transportimi i lëndëve plasëse, kërkon një vlerësim e seriozitet për veprimet që duhen kryer nga përdoruesit e saj.

Jo pak raste e probleme të ndodhura në qarkun Lezhë, si rezultat i veprimeve të kryera nëpërmjet këtyre lëndëve, kanë shkaktuar dëm ekonomik dhe pasoja të tjera. NJQV-të duhet të ndërhyjnë dhe të informojnë shërbimet policore për raste abuzive të shpërthimeve në gurore, për peshkim të paligjshëm e veprime të tjera që mund të përbëjnë konflikt e mosmarrëveshje, pasi policia e ka të vështir të zbulojë ose parandalojë pa ndihmën e pushtetit vendor e të komunitetit.

Mbështetja sa më e madhe për shërbimin policor, shpreh shkallën e emancipimit, në fund të fundit besimin reciprok, që çdo gjë ta zgjidhin nëpërmjet ligjit e strukturave të shtetit. Për çdo veprim të pakujdesshëm apo të qëllimshëm, për të marrë masa të shpejta duhet që të rritet përgjegjësia për njohjen e gjendjes dhe të aktivitetit që kryhet duke patur si faktor të rëndësishëm:

1. Evidentimin e të gjitha depove të lëndëve plasëse shtetërore apo private qofshin, si dhe të personave përgjegjës që i administrojnë ato.

2. Kontrolli i vazhdueshëm i masave të sigurisë, sipas kërkesave të dispozitave ligjore, kryesisht në vëmendje duhet mbajtur mënyra e vendosjes së tyre në qendra banimi apo në objekte të papërshtatshme.

3. Koordinimi i veprimeve dhe i bashkëpunimit, midis policisë dhe pushtetit vendor i të gjitha niveleve, të jetë i vazhdueshëm

Çarmatimi- detyrim ligjor e moral

Rezultatet e grumbullimit të armëve nga policia, tashmë, është një përvojë por edhe një aksion i rëndësishëm. Ligji që vepron për ngjarjet e ndodhura kriminale ka treguar se një pjesë e komunitetit akoma mbajnë armatime të llojeve të ndryshme. Nuk mund të ketë rend e qetësi publike të konsoliduar, kur një pjesë e popullsisë mban armë zjarri. Nuk ka zhvillim e investim derisa konfliktet edhe ato më të vogla, shpesh përfundojnë nën grykën e armëve, kur adoleshentët vendosin maska në kokë, grabisin udhëtarët, ose më keq i vrasin ato siç ka qenë rasti në Komunën e Shëngjinit.

Është akoma e nevojshme, që pushteti vendor-polici në bazë komune e bashkie, të bëjnë analiza të përbashkëta, të ngrejnë grupe pune, duke organizuar kontrole e marrë takime shtëpi më shtëpi e fshat më fshat, për të grumbulluar armë, municione të llojeve të ndryshme që akoma janë në duart e tyre.

Krijimi i një mjedisi sa më të sigurve për mbrojtjen nga zjarri.

Për të sjellë përmirësime në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për të luftuar më shumë se deri më tani, në drejtim të reduktimit të rënieve të zjarrit, si nga pakujdesia

ashtu edhe nga veprimet e qëllimshme, është e domosdoshme që të rritet bashkëpunimi midis partnerëve.

Nga zjarri janë dëmtuar dhjetëra objekte shtetërore e private, banesa të qytetarëve, si dhe janë dëmtuar disa ha me pyje e kullota. Në qarkun tonë, për vitin 2010 kanë rënë 309 zjarre në pyje e kullota, kundrejt 307 zjarreve të regjistruara në vitin 2009.

Grupet hetimore të ngritura për këtë qëllim, nga policia dhe prokuroria, kanë arritur në përfundim se shumica e zjarreve janë shkaktuar nga pakujdesia, por ka patur edhe raste të zjarrvënieve të qëllimshme.

Shërbimi i policisë pyjore, duhet të gjejë forma bashkëpunimi me NJQ, policinë, kryetarët e fshatrave e me komunitetin në tërësi, për parandalimin e zjarreve.

- Për këtë duhet të hartohen plane bashkëpunimi me partnerët sipas administrimit të territoreve.

- Të identifikohen problemet që mund të degjenerojnë në zjarre me pasoja të rënda.

- Të hartohen plane të përbashkëta Polici shteti, Shërbimi zjarrfikës në Prefekturë, për të evidentuar problemet që mund të nxisin zjarre të qëllimshme për probleme pronësie, biznesi etj.

- Të arrihet një organizim më i mirë për të qenë në gatishmëri të plotë për telefonatat emergjente nga të gjitha shërbimet, si hallka të rëndësishme në parandalimin e dëmtimeve që shkaktohen nga zjarri.

Bordet e parandalimit të krimit

Bordet e Parandalimit të krimit, do të funksionojnë si organe konsultative të shefave të komisariateve dhe do të kenë për qëllim diskutimin rreth problemeve të rendit dhe krimit në territorin që mbulon komisariati, si dhe hartimin e planeve konkrete të bashkëpunimit në funksion të evidentimit dhe parandalimit të problematikës që shqetëson komunitetin. Bordet, siç tregohet edhe në grafik mund të përbëhen nga shefat e komisariateve, kryetarët e bashkive/komunave, përfaqësues të Prokurorisë, të biznesit, të arsimit, të OJF-ve, të organizatave rinore, etj

Ngritja e bordeve të tilla, për parandalimin e krimit, në çdo komisarjat policie, është vazhdim i nismës në rang kombëtar, që ka përfshirë aktivitete në të gjitha qarqet e vendit tonë në bashkëpunim me IDN.

Krijimi i Zyrës së Marrëdhënive me Publikun në DPQ, ka lehtësuar dhe do të lehtësojë edhe më shumë kontaktet e shtetasve me punonjësit e policisë.

Jo për komoditet, por për të krijuar kushte të përshtatshme për punë, është e domosdoshme, që kryetarët e bashkive dhe të komunave kryesisht, duhet të sigurojnë zyra e t'i pajisin ato për inspektorët e policisë në zonë. Krijimi i këtyre bordeve, si dhe përvoja të tjera në drejtim të policimit në komunitet, do të ndikojnë pozitivisht, jo vetëm në rritjen e besimit, por edhe në ndryshimin e mentalitetit si për punonjësit e policisë ashtu edhe për aktorët e tjerë bashkëpunues në parandalimin e kriminalitetit. Kontakti i parë i qytetarëve me policinë, në më të shumtën e rasteve, realizohet nëpërmjet telefonatave.

Tashmë numri telefonik 129, që është vënë në dispozicion të publikut pa pagesë, ka dhënë rezultate të ndjeshme në marrjen e denoncimeve nga qytetarët. Rezulton se nga

numri i përgjithshëm i telefonatave 68% e tyre janë bërë objekt verifikimi të specializuar të organeve përkatëse.

Paraqitja skematike e bordeve të parandalimit të krimit.

Qëllimi i Bordeve të parandalimit të krimit do të jetë:

Diskutimi i problemeve specifike të zonës.

Konsultimi për mënyrën e zgjidhjes.

Rritja e bashkëpunimit në kuadër të parandalimit.

Marrja dhe ndarja e përgjegjësive.

Sensibilizimi i komunitetit për të bashkëpunuar në veprimtaritë reduktuese dhe parandaluese të krimit.

Takimet e Bordit do të organizohen në mënyrë periodike ose sipas problematikës që del. Në këto takime, mund dhe duhet të ftohen sipas rastit edhe ndihmës

administratorët e lagjeve në qytete dhe kryetarët e fshatrave si dhe përfaqësues të grupeve të interesit dhe të komunitetit.

Partneriteti, bashkëpunimi dhe transparenca e policisë me publikun

Aktorët kryesorë, që do të realizojnë atë çfarë përmban ky dokument, duhet të punojnë sistematikisht, për të ndryshuar mentalitetin e efektivave të policisë në tërësi, që të mos e shohin institucionin e tyre si bunkier, si aparat të dhunës (sipas mentalitetit të vjetër), pasi lartësimi i institucionit dhe rritja e besimit publik, do të mund të realizohet në bashkëpunim me qytetarët dhe vetëm me ata.

DPQ, do të organizojë takime llogaridhënëse me komunitetin, në mënyrë të vazhdueshme e në nivele të ndryshme të efektivave të saj, që nga drejtuesit e lartë e deri tek punonjësi i policisë së zonës.

Nisma e llogaridhënies publike, e realizuar deri më sot nga DPQ Lezhë, e cila edhe është përgjithësuar, duhet të mbetet si forma më vitale e komunikimit publik të policisë me qytetarët, institucionet dhe shoqërinë në tërësi. Kjo formë komunikimi, e bën policinë të dëshmojë detyrimin e njëkohësisht vlerën e saj si shërbim publik. Ajo që duhet të mbahet parasysh në vazhdimësi, është se, këtë formë llogaridhënie, duhet të përmirësohet drejt standardeve perëndimore. Si lufta kundër krimit, ashtu edhe përpjekjet për parandalimin e tij, do të bëhen objekt i krejt shoqërisë, pasi siç ka thënë një filozof humanist evropian **“shoqëria është më imagjinate, më krijuese dhe më pjellore se shteti”**, pra dhe se policia.

Partneriteti me biznesin lokal

Ky partneritet, duhet të konsiderohet, si një nga problemet më të rëndësishme të bashkëpunimit me komunitetin. Në funksion të rritjes së këtij bashkëpunimi dhe perfeksionimit të tij të paktën çdo gjashtë muaj, DPQ dhe Dhoma e Tregtisë, do të bëjnë vlerësimin e bashkëpunimit dhe evidentimin e problematikave kryesore të sigurisë së zhvillimit normal të aktiviteteve të ndryshme të biznesit, në funksion të krijimit të një klime sa më të favorshme të aktivitetit të biznesit në këtë rajon.

Bashkëpunimi me biznesin dhe angazhimi i këtij të fundit, për pajisjen e zyrave dhe në përgjithësi të ambienteve të godinës së rikonstruktuar të DPQ dhe të KP Lezhë, është një tregues domethënës, që dëshmon për rritjen e autoritetit e të besimit të ndërsjellët publik -polici

Partneriteti dhe bashkëpunimi me NJQV-të

Duhet përgjithësuar fakti se, DPQ Lezhë, këtë vit sidomos, ka promovuar dhe nxitur strategji bashkëpunimi efikase me organet dhe strukturat e pushtetit vendor. Ky bashkëpunim është konsideruar si një nga angazhimet themelore të policisë dhe ka dhënë rezultate të prekshme. Për këtë, janë vendosur linja komunikimi në rrugë institucionale

për shkëmbimin e informacionit, që është fokusuar në problematikat që u ka interesuar palëve. Rezultatet konkrete kanë qenë të dukshme, sidomos në rritjen e përqindjes së zbulueshmërisë së kriminalitetit.

Bashkëpunimi nuk ka qenë vetëm verbal, por kryesisht me shkrim dhe ka synuar nxitjen e përgjegjshmërisë dhe reagimit të pushtetit vendor, për ato probleme që kanë shqetësuar komunitetin, në aspekte të sigurisë publike dhe që kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrjen e pushtetit vendor. Falë këtij bashkërendimi të punëve, në mjaft raste janë zgjidhur në kohë dhe pa pasoja një sërë konfliktesh sidomos ato të pronësisë, në disa njësi vendore të rajonit tonë si p.sh. në komunat Fan, Selitë, Kaçinar (Mirditë), në komunat Zejmen, Kolsh, Shëngjin (Lezhë), në Komunat Milot, Fushë Kuqe (Kurbin) etj. Në të ardhmen, do të forcohet akoma më shumë bashkëpunimi midis Policisë dhe NJQV-ve, madje jo vetëm spontan por me plane paraprake veprimi sipas problematikave që do të lindin .

Partneriteti midis institucioneve arsimore dhe policisë

Për krijimin e një partneriteti të qëndrueshëm mes institucioneve arsimore dhe policisë së shtetit, nevojitet që:

- DPQ dhe DRA Lezhë do të hartojnë dhe të realizojnë një plan të përbashkët bashkëpunimi.

- Po kështu duhet të veprojnë edhe KP me ZA në rrethet Kurbin dhe Mirditë.

- Planet e përbashkëta dhe të mirëstudjuara do t'i shërbejnë parandalimit të krimit në format e tij të ndryshme si; trafiket e qenieve njerëzore, lëndët narkotike, problemet e qarkullimit e sigurisë rrugore, si dhe çështjeve të tjera që do të konsiderohen të rëndësishme. Problemi më i mprehtë për të cilin duhet të shkëmbehet informacioni i ndërsjellë e të bashkëpunohet në mënyrë intensive dhe të kualifikuar, është ai i evidentimit të rasteve të shpërndarjes dhe të përdorimit të lëndëve narkotike në ambientet e shkollave të mesme por edhe në ato të 9-vjeçarëve.

Në kuadrin e programeve edukative të DRA, janë evidentuar nxënësit me nevoja të veçanta, me probleme sociale dhe ekonomike me prindër të divorcuar, si dhe me tendenca braktisje të shkollës. Me zbatimin e programit “shansi i dytë”, janë caktuar 5 mësues dhe kanë punuar me 125 nxënës (90 në qytetet Lezhë e Shëngjin dhe 35 në Komunat Shënkoll e Dajç). Në shkollën e qytetit Shëngjin, janë tërhequr 16 fëmijë të rrugës (rom). Edhe në shkollën “Gjergj Fishta” të qytetit Lezhë, janë integruar mirë 25 nxënës (rom). Me të njëjtën përvojë punohet edhe në shkollat e rrethit Laç dhe Mirditë.

Në vitin shkollor 2009-2010 kanë braktisur shkollën si më poshtë:

Në rrethin e Lezhës 4 nxënës.

Në rrethin e Kurbinut 18 nxënës.

Në rrethin e Mirditës 1 nxënës.

Gjithsej 23 nxënës, kundrejt 53 braktisjeve në vitin shkollor 2008-2009, çka tregon se numri i braktisjeve ka ardhur në ulje.

Aktorët e kësaj strategjie, do të bashkërendojnë punën sipas motos zero tolerancë ndaj fenomenit të braktisjes së arsimit të detyruar, jo vetëm nga fëmijët rom, pasi integrimi i tyre në shkollë është një garanci që ata t'u shpëtojnë kthetrave të

tregtarëve të qenieve njerëzore.

Gjithashtu, praktika jetësore ka vërtetuar se të rinjtë që braktisin shkollën, përbëjnë numrin më të madh të personave që përfshihen në krim për motive nga më të ndryshmet.

Në bazë të ligjit të ri të gjendjes civile, po bëhet regjistrimi i të gjithë fëmijëve romë si dhe po bëhen përpjekje që në këto zona të vihen në funksion shkolla dhe ambiente ushqimi si një mundësi për t'i mbrojtur dhe shkolluar fëmijët e këtij komuniteti.

Do të synohet që inspektorët e policisë së rendit, ta kenë shkollën mjedis ku hynë e bisedojnë lirshëm me nxënësit.

Punonjësit e policisë do të ndërgjegjësohen edhe më shumë, në radhë të parë për detyrimin moral që kanë, por edhe ligjor, për të marrë pjesë direkt në edukimin e brezit të ri duke praktikuar forma konkrete të bashkëpunimit me shkollën.

Ky bashkëpunim do të jetë pjesë e strategjisë “Për Sigurinë Publike dhe Parandalimin e Krimit” në Qarkun e Lezhës.

Ky dokument, ka për qëllim, përveç të tjerave, që të ndërtojë një bashkëpunim ndryshe mes policisë dhe institucioneve arsimore, i cili nuk mund dhe nuk duhet të limitohet e të reduktohet tek prezenca fizike e një punonjësi policie në hyrje të shkollave.

Bashkëpunimi i partnerëve me shkollat do të shihet si domosdoshmëri për parandalimin e krimit dhe të fenomeneve që gjenerojnë krim.

Partneriteti dhe bashkëpunimi me mediat

Për vetë rëndësinë që ka “pushteti mediatic”, domosdoshmërisht ky partneritet, do të konsiderohet si një ndër faktorët më të rëndësishëm në arritjen e rezultateve dhe promovimin e nismave dhe aktiviteteve konkrete në dobi të komunitetit. Për rrjedhojë, për të siguruar një proces transparent e të monitorueshëm, është e rëndësishme që:

- Të rikonceptohen dhe të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet me mediat lokale dhe kombëtare.

- Media të konsiderohet si partner i rëndësishëm në luftën për parandalimin e krimit, hapjen e policisë ndaj qytetarëve, rritjen e bashkëpunimit dhe besimit publik tek policia e shtetit.

- Nga ana e saj edhe media duhet të tregojë profesionalizëm, integritet, paanshmëri, koherencë dhe mbi të gjitha dinjitet në përcjelljen e lajmeve për publikun.

Objektivat afatmesme të partnerëve për parandalimin e krimit dhe sigurimin e qetësisë publike:

Thellimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe në veçanti i trafikëve të paligjshme, drogës e krimeve në fushën ekonomike e financiare, që kryhen nëpërmjet territorit të qarkut Lezhë.

Parandalimi e reduktimi i dhunës në marrëdhëniet standarde familjare dhe veprimtarisë kriminale me objekt fëmijët.

Rritja e standardeve të sigurisë në të gjithë territorin e Qarkut gjatë zhvillimit të

aktiviteteve të ndryshme.

Forcimi i marrëdhënieve të partnerëve me komunitetin, me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe me subjektet e ndjekjes penale.

Thellimi e perfeksionimi i luftës kundër krimit ekonomik, sidomos goditja e fenomenit të korrupsionit të shfaqur në institucionet shtetërore dhe administratën publike, duke e parë këtë si një nga prioritetet e punës të të gjithë partnerëve.

Realizimi i detyrave për parandalimin e akteve terroriste.

Reduktimi, zbulimi dhe goditja e krimeve kundër personit dhe pasurisë që cenojnë e dëmtojnë drejtpërdrejt interesat e shtetasve.

Forcimi i besimit publik tek shërbimet që institucionet shtetërore i ofrojnë komunitetit.

Rritja e sigurisë në rrugë në standardet e kërkuara si dhe parandalimi i aksidenteve automobilistike (minimizimi i tyre).

Vendosja e partneritetit dhe bashkëpunimi me organe, institucione dhe faktorë të tjerë me ndikim në qarkun e Lezhës.

Zbatimi i strukturave të reja, aftësimi i duhur i punonjësve të policisë me anë të trajnimeve sipas kërkesave aktuale dhe realizimi i efektivitetit të duhur të të gjitha strukturave dhe punonjësve të policisë.

Krijimi dhe përmirësimi i kushteve të punës për të gjitha strukturat e policisë.

Bashkërendimi i punës i të gjithë partnerëve për parandalimin e pajtimin e mosmarrëveshjeve, konflikteve e të gjakmarrjes.

Papunësia në Qarkun Lezhë

Është e rëndësishme për partnerët e zbatimit të këtij dokumenti, njohja e problemeve të punësimit në rajon, pasi papunësia prodhon elemente krimi, sjell varfëri, padurim, revoltë, reagime të ashpra etj.

Vitet	Gjithsej Qarku	Lezha	Kurbini	Mirdita
2007	13500	2800	7400	3300
2008	13750	2850	7800	3100
2009	14340	3025	6959	4353
2010	14001	3200	7635	3166

Po t'i referohemi tabelës së mësipërme, vërejmë se për vitin 2010 në Qarkun Lezhë, janë evidentuar rreth 399 të papunë më pak se në vitin 2009.

Ulja e nivelit të papunësisë, ka ardhur si rezultat i zbatimit të politikave lehtësuese të qeverisë shqiptare në përmirësimin e klimës së biznesit, në hapjen e vendeve të reja të punës nëpërmjet investimeve të shumta, kryesisht në infrastrukturë, dhe në zbatimin e programeve të punësimit.

Në këtë periudhë, vërehet një situatë e favorshme për punësim, pasi ka oferta punësimi në sektorin e ndërtimit të rrugëve, si në Milot-Rrëshen, Shëngjin, Lezhë, Laç. Po kështu, po kryhen një sërë investimesh në riparime rrugësh, trotuaresh, ujësjellësish, kanalizimesh, në punishtet e përpunimit të peshkut si “ Poseidon” shpk “ Rozafa” dhe “Eurofish” etj në qytetet e rajonit tonë.

Ndikim në shtimin e të punësuarve, do të ketë ndërtimi i zonës industriale në rajonin Shëngjin – Lezhë, Balldre etj.

Partnerët e realizimit të kësaj strategjie, sidomos NJQV, por edhe aktorët e tjerë, duhet të bëjnë të mundur, nëpërmes njohjes dhe zbatimit të politikave të punësimit duke zbutur këtë fenomen.

Paraqitja skematike e aktorëve pjesëmarrës

Pjesë plotësuese të këtij dokumenti do të jenë:

Plan i detajuar masash për sigurinë e parandalimin e krimit i strukturave vendore të policisë e të NJQV-ve.

Plani i bashkive e komunave për administrimin e territorit dhe identifikimin e problemeve që mund të gjenerojnë krim(sidomos problemet e pronësisë).

Hartimi i hartës sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore.

Plane të ZA të rretheve dhe të drejtorive të shkollave.

Plane për mbrojtjen e fëmijëve.

Plani i përmirësimit të shërbimit shëndetësor.

Plan konkret në bashkëpunim me bizneset vendore kundër varfërisë(duke u përqendruar në rastet emergjente).

Evidentimi i problemeve të strehimit, nga bashkitë e qarkut.

Plane të organizatave rinore.

Mbështetja në strategjitë dhe planet e zhvillimit ekonomik kombëtar.

Plane të përgatitura nga OJF-të, që operojnë në këtë fushë.

Detyra dhe objektiva për të ardhmen, me synim përmirësimin e treguesve, që dalin përgjatë studimit.

Objektivat	Detyra/ aktivitete	Kush përgjigjet	Afati kohor	Kosto
1	2	3	4	5

<p>1. Thellimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit</p>	<p>1. Goditja e grupeve kriminale, që janë të përfshira në pastrimin e parave dhe e realizojnë këtë aktivitet nëpërmjet biznesit në fushën ndërtimore etj.</p>	<p>Drejtoria e policisë. Prokuroria Lezhë e Kurbin. Autoritetet e qeverisjes vendore.</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Të identifikohet.</p>
	<p>2. Goditja e subjekteve private të cilat u shmangen detyrimeve financiare duke sjellë invazion fiskal.</p>	<p>D.P.Q. D.R.T. Prokuroria.</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>
	<p>3. Inicimi i veprimtarive të ndryshme me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit e sidomos të adoleshentëve për pasojat e përdorimit të drogës.</p>	<p>Komisariati i policisë dhe zyrat Arsimore në Lezhë Kurbin e Mirditë.</p>	<p>Për çdo 6 mujor.</p>	<p>Të identifikohet.</p>
	<p>4. Mbajtja nën kontroll e fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të tyre.</p>	<p>Seksioni i policisë kriminale në DPQ Autoritetet e qeverisjes vendore.</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>

	<p>5. Forcimi i bashkëpunimit me Qarqet (Shkodër e Durrës), që kufizohen me rajonin Lezhë, për reduktimin e mundësisë së furnizimit me lëndë narkotike.</p>	<p>DPQ Prokurori</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar</p>
--	--	--------------------------	--------------------	--------------------------------

<p>Zhvillimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit</p>	<p>6. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga strategjitë.</p> <p>-Kundër trafiqeve të qenieve njerëzore.</p> <p>-Kundër trafikimit të fëmijëve.</p>	<p>Partnerët</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p> <p>Nuk ka ndikim financiar.</p>
	<p>7. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi rrezikun e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme.</p>	<p>Seksioni i policisë kriminale në DPQ dhe Drejtoria Arsimore Lezhë</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>

Lufta kundër krimit financiar.	<p>1. Nëpërmjet institucioneve të edukimit, por dhe me projekte konkrete e seminare, të bëhet ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi mitmarrjen dhe mitdhënien si veprime të shëmtuara antiligjore</p>	P o l i c i a P r o k u r o r i a S H I S H D A R	Në vijimësi	Nuk ka ndikim financiar
	<p>2. Të evidentohet numri i të punësuarve “në punë të zezë” dhe të ndëshkohen përgjegjësit në bazë të ligjit përkatës. 3.Nxitja e punësimit në qarkun e Lezhës nëpërmjet projekteve konkrete .</p>	DRP, NJQV, Kryetarët e fshatrave dhe ndihmës administratorët	Në vijimësi	Nuk ka ndikim financiar
II. Menaxhimi i integruar i kufijve.	<p>1.Përmirësimi i bashkëpunimit për rritjen e nivelit të kontrollit të kufirit blu dhe jeshil në vijën kufitare të Shëngjinit.</p>	Stacioni i PKM Shëngjin, Dr.shkollave, NJQV, Autoritetet e Komunës. Kryetarët e fshatrave dhe ndihmës administratorët	Në vijimësi.	Nuk ka ndikim të rëndësishëm financiar.

	2.Përmirësimi i nevojave për ambiente në përputhje me riorganizimin strukturor të PKM.	Stacioni i PKM në bashkëpunim me biznesin në Shëngjin.	2011	Për tu identifikuar.
	3. Bashkërendimi i punës midis partnerëve për minimizimin dhe zhdukjen e fenomenit të trafikeve ilegale në tërësi.	Stacioni Policisë Kufitare Shëngjin. Autoritetet e qeverisjes vendore.	Në vijimësi.	Nuk ka ndikim të rëndësishëm financiar.
III. Ndërtimi i partneritetit	1. Krijimi i grupeve të përbashkëta në nivel rajonal dhe lokal si dhe hartimi i planeve përkatëse të bashkëpunimit.	DPQ, Prokuroria, DRA, SHISH, PKM, DKSHA, Komisarati i policisë Lezhë Kurbin e Mirditë. Nj.Q.V.	Shkurt 2011	Nuk ka ndikim financiar.
	2. Marrja dhe ndarja e përgjegjësiave me partneret, krijimi dhe përmirësimi i linjave të komunikimit.	Partneret.	Mars 2011	Nuk ka ndikim financiar.

<p>IV. Përmirësimi punës për ndërtimin e besimit.</p>	<p>1. Të identifikohen nevojat e publikut për policinë dhe vendosja e tyre si prioritete të veprimtarisë së aktoreve realizues të kësaj strategjie.</p>	<p>DPQ dhe partneret.</p>	<p>2011</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>
<p>V. Reduktimi i krimit dhe sjelljes antishoqërore.</p>	<p>1. Hartimi dhe zbatimi i planit të veprimit për policinë në komunitet.</p>	<p>Drejtoria e policisë qarkut Lezhë.</p>	<p>2011</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>
	<p>2. Përmirësimi i procedurave të evidentimit dhe raportimit të krimit. Njohje sistematike e partnerëve me statistikat e krimit.</p>	<p>Drejtoria e policisë qarkut Lezhë.</p>	<p>Në vijimësi.</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar.</p>

3. Mbrojtja e fëmijëve.
Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia kombëtare “Për mbrojtjen e fëmijëve”2005-2010

4. Studimi i fenomenit të trafikimit të fëmijëve në nivel qarku në funksion të mbrojtjes së tyre.

5. Të riorganizohet bashkëpunimi i DPQ me pushtetin vendor për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe të problemeve të gjakmarrjes.

6. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga ligji Nr. 9669 Dt. 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

7. Zbatimi i

V. Reduktimi i krimit dhe i sjelljes antishoqërore.

8. Të sigurohet grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet partnerëve lidhur me viktimat dhe personat që kryejnë krime.

9. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e policisë shtetit 2007-2013.

10. Zgjerimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis partnerëve të kësaj strategjie për mbledhjen e municioneve luftarake.

11. Forcimi i bashkëpunimit me mediat për një sensibilizim të opinionit publik lidhur me punën që është bërë e bëhet për pajtimin e konflikteve dhe deri tek pajtimi i gjaqeve.

<p>VI. Bashkërendimi i punës së policisë me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë për rritjen e sigurisë rrugore.</p>	<p>1. Integrimi i shërbimit të policisë rrugore në filozofinë e policimit në komunitet.</p> <p>2. Përmirësimi i punës së partnerëve me komunitetin dhe institucionet shtetërore.</p> <p>3. Shtrirja e rrjetit të raportimeve të aksidenteve në strukturat vendore.</p> <p>4. Të bëhet studimi për vendosjen e mbrojtjes anësore, të mbi e nënkalimeve si dhe për kompletimin me një sinjalistikë bashkëkohore në segmentin rrugor Fushë-Krujë-Lezhë.</p>	<p>Drejt. pol. Qarkut, NJQV.</p> <p>Institucioni i Prefektit.</p> <p>Shefat e komisariateve në rrethe me NjQV.</p> <p>DPQ, NJQV (Laç, Mamurras, Kolsh, Lezhë, Shënkoll)</p>	<p>Në vijimësi.</p> <p>Në vijimësi.</p> <p>Në vijimësi.</p> <p>6-mujorin e I-rë 2011</p>	<p>Nuk ka ndikim financiar</p> <p>Mbetet për tu identifikuar.</p> <p>Nuk ka ndikim financiar</p> <p>Mbetet për t'u identifikuar</p>
---	--	---	--	---

<p>VII. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të burimeve mbështetëse</p>	<p>1. Rritja e transparencës nëpërmjet përmirësimit të komunikimit të brendshëm midis partnerëve.</p> <p>2. Paisja me zyrë pune e punonjësve të policisë në zonë.</p> <p>3. Realizimi i takimeve llogaridhënëse me publikun me qëllim që policia të afrohet normalisht e natyrshëm tek qytetari.</p> <p>4. Organizimi i takimeve me mediat lokale, për përmirësimin e punës në lidhje me përcjedhjen e lajmeve që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftën kundër krimit.</p>	<p>Partneret</p> <p>NJQV, DPQ dhe Biznesi</p> <p>Shefat e kom. Policisë, Autoritetet vendore</p> <p>Kom.Policisë në rrethe, drejtuesit e mediave, NJQV</p>	<p>Në vijimësi.</p> <p>2011</p> <p>Në vijimësi</p> <p>Në vijimësi</p>	<p>Nuk ka ndikim të ndjeshëm financiar</p> <p>Mbetet për tu identifikuar.</p> <p>Nuk ka ndikim financiar</p> <p>Nuk ka ndikim financiar</p>
---	---	--	---	---

VIII. Donacionet dhe projektet e zhvillimit.	1. Orientimi i donacioneve dhe projekteve të zhvillimit në përputhje me prioritetet strategjisë për “Sigurinë dhe parandalimin e krimit” në qarkun e Lezhës.	Drejtoria e programim-zhvillimit në Këshillin e qarkut Lezhë në bashkëpunim me DPQ.	Në vijimësi.	Nuk ka ndikim të rëndësishëm financiar.
--	---	---	--------------	---

Bibliografia

- Fletorja Zyrtare nr.150, viti 2006
Fletorja Zyrtare nr. 22, viti 2004
Këshilli i Ministrave. Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013, viti 2008
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 9859 datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, Fletorja Zyrtare nr.10, viti 2008
Urdhëri i Kryeministrit nr. 203 datë 19.12.2005 “Për mënyrën e funksionimit të Njësisë Antitrafik”
Sotiraq Hroni Drejtor i IDN.Buletin Nr.2 Viti i5-të i botimit
Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013
Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010
Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit.
Mbledhja e Komitetit shtetëror të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore dt. 11 maj 2007 (publikuar në periodikun gazeta “Republika”)
Raporti i Projektit CARPO, mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg, gusht 2006, versioni shqip f.71
Çështje të sigurisë Security Issues (Revistë e periodike 2008).
Besimi publik, sfidë për policinë nr.2 dhe nr. 5. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN)
Gazeta Koha Jonë, RD, “55” etj.
Buletine te (I D N), Nr.1,2,3,11,12 etj.
Rrjeti kundër dhunës gjinore dhe trafikimit, (Buletin Dhjetor 2008)

PAGE

PAGE 41

PAGE

PAGE 41

Drejtoria e Policise se
Qarkut Lezhe

Stacioni i Pol.
Shengjin

Stacioni i Pol.
Milot

Stacioni i Pol.
Mamurras

Kom.Policise
Mirdite

Kom.Policise

Lezhe

Kom.Policise
Kurbini

Stacioni i Pol.
Reps

Komisarjatet

Sektoret

Drejtoria e Polise se
Qarkut Lezhe

EMBED Excel.Chart.8 \s

EMBED Excel.Chart.8 \s

EMBED Excel.Chart.8 \s

EMBED Excel.Chart.8 \s

Inst. per Demokraci e Ndermjetesim

Komunitetet fetare

Shoqata e Pajtimimit te gjaqeve

Mediat Lokale

Drejt. e Shend. Publik

D.R.A
e
Qarkut

Komunat e Qarkut

Bashkite
e Qarkut

Gjykata e Qarkut

Prokuroria e Qarkut

Drejtoria e Policise

Institucioni i Prefektit

**Keshilli
i
Qarkut Lezhe**